REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK DIVJAKË

Nr 6918/4 Prot. Divjakë më 20.08.2026

THIRRJE
"PËR ZHVILLIMIN E MBLEDHJES SË RADHËS TË KËSHILLIT BASHKIAK DIVJAKË, MUAJI GUSHT , 2026"

ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK

Për dijeni: **KRYETARIT TË BASHKISË DIVJAKË**
PREFEKTIT TË QARKUT FIER

Në mbështetje të nenit 53 pika 4, neni 56, pika 2, gërma (a) të Ligjit nr 139, datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*",i ndryshuar, Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Divjakë, miratuar me VKB, nr 28 datë 13.04.2020, ndryshuar me V.K.B. Nr.48 datë 25.09.2023, neni 56, **Ju njoftojmë se:** Më datë: **28 .08. 2026, ditën e Premte , ora 10:00,** tek Salla e mbledhjeve, kati i dytë, në Godinën e Bashkisë Divjakë, thirret "Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Divjakë për muajin Gusht **2026**". **Me këtë Rend dite:**

1.Miratim i Rendit të Ditës.
2.Miratim i Proçesverbalit të mbledhjes që u zhvillua më datë 24.07.2026 dhe proçesverbalit të mbledhjes së datës 14.08.2026**.**
3.Informacion mbi zbatimin e Vendimeve të Këshillit Bashkiak Divjakë për muajin Korrik, 2026.
4.**Projekt-vendim Nr.71,datë, 05. 08. 2026:** Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri 6%, për muajin Korrik, 2026.
5.Projekt-vendim Nr.73,datë, 13. 08 .2026: Mbi miratimin e përfundimit të proçedurës së privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ASHK, pranë Drejtorisë Vendore Lushnje, për lidhjen e kontratave para noterit.
6.**Projekt-vendim Nr.74,datë,14. 08.2026:** Për miratimin e projektit"Fuqizimi i të rinjve, përmes Qendrës multifunksionale rinore Tërbuf"
7.Projekt-vendim Nr. 75,datë, 14. 08. 2026:Mbi anullimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 62 datë 24.07.2026 " Për miratimin e dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar në programin " Emergjencat civile" për vitin 2026".
8. Projekt-vendim Nr. 76,datë, 14. 08. 2026: " Mbi akordimin e ndihmës financiare për familjet e dëmtuara nga zjarri"
9. Projekt-vendim Nr. 77,datë, 17. 08. 2026:Për miratimin e shtesës së fondeve në transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe në transfertën e pakushtëzuar sektoriale në buxhetin e v. 2026.
10. Projekt-vendim Nr. 78, datë, 17. 08. 2026: Për miratimin e një rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2026.
11. Projekt-vendim Nr. 79.datë, 17. 08. 2026:Për miratimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar në programin" Emergjencat civile"
12.Projekt-vendim Nr. 80.datë, 28 . 08. 2026: Për miratimin e ndihmës financiare për shtetasin Islam Mehmet Dinoshi për banesën e dëmtuar nga zjarri.
13. Informacion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit " Për Aktivet e Bashkisë Divjakë.
Sqarim: Komisionet përgjegjës sipas pikave në Rendin e ditës janë:-Komisioni i Ekonomisë dhe financave, për pikat nr: **4,6,7,8,9,10,11.** Komisioni i Urbanistikës, Infrastrukturës dhe Strehimit, për pikën **5.**

Duke ju falenderuar !

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK
Liri Biti

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA DIVJAKË

Adresa:Sheshi"SantaBarbara"Qendra:Divjakë. Email:info@bashkiadivjake.gov.al.